



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z.A

ZNJ. M.P

E nderuar znj. P!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e redaksisë suaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të datës 26.01.2021, regjistruar me aktin nr. 369 Prot., datë 26.01.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Aktualisht në sistemin gjyqësor janë **53 vakanca të përhershme, si rezultat i tre komponentëve:**

- (i) Të paplotësuara prej fillit të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- (ii) Për shkak të mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjeve;
- (iii) Si pasojë e mbushjes së moshës për pension.

Këto vakanca ndahen si më poshtë vijon:

- a) 15 vende vakante në Gjykatën e Lartë;
- b) 20 vende vakante në gjykatat e Apelit;
- c) 18 vende vakante në gjykatat e Rrethit Gjyqësor.

Si pasojë e rivlerësimit kalimtar kemi vakanca të përkohshme (pasi gjyqtaret paguhen në masën 75% pagës dhe i ruhet vendi deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, pra deri sa Kolegji i Posaçëm i Apelit të shprehet me vendim të formës së prerë.

Janë **44 vakanca të përkohshme si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar**, pra të gjyqtarëve të cilët janë shkarkuar nga detyra me vendim të KPK, konkretisht:

- a) 26 gjyqtarë të gjykatave të Apelit;
- b) 18 gjyqtarë të gjykatave të Rrethit Gjyqësor.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijon punën intensive dhe po ndërmerr çdo hap të nevojshëm, për të përfunduar sa më parë procesin e plotësimit të vendeve të lira në Gjykatën e

Lartë dhe në të gjithë sistemin gjyqësor, për të garantuar aksesin e qytetarëve në drejtësi. Në këtë kontekst, ju informojmë se KLGJ filloi procedurat për paraqitjen e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, menjëherë pas plotësimit të kuadrit nënligjor (Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë - Vendimi Nr. 75, datë 23.05.2019; Rregullat për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë - Vendimi Nr.102 datë 5.07.2019). Në përfundim të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimit sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve, me vendimet Nr. 110, 111 dhe 112, datë 27.2.2020, mbi bazën e të cilëve u emëruan si Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë respektivisht me dekretet Nr.11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës. Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin për pozicionin e katërt nga radhët e juristëve të spikatur. Në mbledhjen e datës 13.11.2020, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të kandidatit të fundit nga radhët e juristëve të spikatur, Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e fazës së dytë, të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes, të z. Darjel Sina. Shih: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-13-nentor-2020/>

Vendimi Nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i hapi rrugë edhe promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. KLGJ, me qëllim plotësimin e pozicioneve të tjera të lira në Gjykatën e Lartë, në mbledhjen e datës 26.2.2020, vendosi fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve. Me vendimet Nr. 82, 83 dhe 84 datë 26.02.2020, është vendosur fillimi i procedurës së ngritjes në detyrë, në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, si dhe me vendimet Nr. 85, 86 dhe 87, datë 26.02.2020, është vendosur fillimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës civile. Për vendimet e sipërpërmendura, Këshilli ka caktuar relatorët, si dhe ka përfunduar fazën e parë të verifikimit të plotësimit të kriterëve formale dhe ligjore. Informacion mbi procedurat e promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë gjendet në linkun e mëposhtëm:

<http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-lartë/>

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 09.07.2020, me vendimet Nr. 241, 242, 243, 244 dhe 245, vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për katër pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale dhe një pozicion në fushën e të drejtës administrative. Për vendimet e sipërpërmendura, Këshilli ka caktuar relatorët, si dhe ka nisur procesin e mbledhjes së dokumentacionit përkatës nga institucionet e caktuara me ligj. Informacion më i detajuar gjendet në linkun:

<http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-lartë/>

Në mbledhjen e datës 26.11.2020, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, Këshilli vendosi përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë, për dyandidate për në Gjykatën e Lartë. Informacion më i detajuar gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-26-nentor-2020/>

Në lidhje me numrin e kandidatëve për çdo pozicion të shpallur, informacioni i plotë gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-lartë/>

Gjithashtu, referuar vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, Këshillin i Lartë Gjyqësor duhet të vijojë procedurën e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për një kandidate. Në zbatim të këtij vendimi, KLGJ vendosi në datën 10.12.2020, fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për znj. Saida Dollani, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura në datën 09.07.2020. Informacion më i detajuar gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-10-dhjetor-2020/>

Për vendet vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, aplikuan 23 kandidatë, nga të cilët 4 kandidatë janë kualifikuar, ndërsa të tjerët janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kritereve të kandidimit, të tilla si: ndalimi i riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë, mosmbajtjes së gradës shkencore në drejtësi; largimit nga detyra për shkaqe disiplinore si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; mosplotësimit të kriterit të përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës; të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.

Për vendet vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, kanë aplikuar 23 kandidatë, nga të cilët 2 kandidatë janë tërhequr nga kandidimi, ndërsa 15 kandidatë janë kualifikuar, për të cilët është marrë vendim i formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar/vettingut, 1 kandidat është në pritje për t'u kualifikuar, 1 kandidat është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim që ende nuk është arsyetuar e nuk ka marrë formë të prerë, ndërsa 4 kandidatë janë në proces rivlerësimi kalimtar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në të 6 gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për të cilat kanë kandiduar 26 gjyqtarë. Aktualisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë verifikimin paraprak të plotësimit nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit, si dhe ka filluar procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Vendimet përkatëse ndodhen në faqen zyrtare të KLGJ-së, në rubrikën vendime, në kategorinë 'akte administrative individuale' në linkun, <http://klgj.al/akte-administrative-individuale/>.

Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 26.02.2020, ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë, në total për 5 pozicione të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Në këto procedura kanë kandiduar gjithsej 4 kandidatë, ndërkohë që njeri prej tyre më pas është tërhequr nga kandidimi. Në këto procedura ngritje në detyrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë verifikimin e plotësimit nga 3 kandidatët të kritereve të kandidimit, duke i kualifikuar ata për vijimin e mëtejshëm të procedurave, për 3 pozicione të lira. Për këta kandidatë, aktualisht po vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional. Edhe këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar po vijnë, ku pas përfundimit të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për të gjithë kandidatët, për secilin pozicion të lirë, si dhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, bazuar në renditjen e tyre sipas kritereve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vendosë për ngritjen në detyrë, për çdo pozicion të lirë. Ju bëjmë me dije gjithashtu, se për pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar për të cilat nuk ka pasur kandidatë, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka rihapur disa herë ato, duke ftuar gjyqtarët për të konkurruar.

Nga ana tjetër, për të eliminuar vonesat, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka ndërmarrë, për sa ligji e lejon, disa masa në drejtim të funksionalitetit të gjykatave të apelit.

Një nga këto masa ka qenë ngritja dhe bërja efektive e skemës së delegimit, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 22, datë 07.02.2019. Në vijimësi KLGJ i ka bërë thirrje publike të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kriteret të kandidojnë për të qenë pjesë e skemës së delegimit. Për më tepër shih linkun: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/09/thirrjeperkandidimneskememedelegimit-2.pdf>

Gjatë, kësaj periudhe, KLGJ ka **komanduar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes skemës së delegimit 8 gjyqtarë, si më poshtë vijon:**

1. Me Vendimin nr.317, datë 16.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtaren znj. **Arta Duka, të cilën, me Vendimin nr.318, datë 16.09.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për periudhën deri më datë 16.09.2021.**

2. Me Vendimin nr.401 datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtaren znj. **Igerta Hysi, të cilën, me Vendimin nr.402, datë 07.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për periudhën deri më datë 07.10.2021.**

3. Me Vendimin nr.403, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Laurent Fuçia, të cilin, me Vendimin nr.404, datë 07.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri më datë 07.10.2021.**

4. Me Vendimin nr.428, datë 14.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Erjon Çela, të cilin, me Vendimin nr.429, datë 14.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për periudhën deri më datë 14.10.2021.**

5. Me Vendimin nr.430, datë 14.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Dritan Hasani, të cilin, me Vendimin nr.431, datë 14.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për periudhën deri më datë 14.10.2021.**

6. Me Vendimin nr.524, datë 27.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Florjan Kalaja të cilin, me Vendimin nr.525, datë 27.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për periudhën deri më datë 05.11.2021.**

7. Me Vendimin nr.527, datë 27.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Engert Pëllumbi, të cilin, me Vendimin nr.528, datë 27.10.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri më datë 05.11.2021.**

8. Me Vendimin nr.546, datë 05.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka komandur në skemën e delegimit të ngritur pranë tij gjyqtarin z. **Sokol Pina të cilin, me Vendimin nr.547, datë 05.11.2020, e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për periudhën deri më datë 05.11.2021.**

Në lidhje me vështirësitë dhe kthimin në normalitet, veç masave të sipër cituara, ju informojmë se procesi i plotësimit të vendeve vakante në sistemin gjyqësor, sa i përket afateve kohore, nuk mund të parashikohet me saktësi, për shkak të procesit kompleks të procedurës së emërimit, që përfshin një sërë institucionesh në vend. Megjithatë, Këshilli ka ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të përfunduar sa më parë procesin e plotësimit vakancave në Gjykatën e Lartë, gjykatat e Apelit dhe gjykatat e Rrethit Gjyqësor, duke mbajtur në konsideratë gjithmonë cilësinë e kandidatëve që do përzgjidhen.

Në çdo rast KLGJ, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim intensifikimin e koordinimit të veprimtarisë së dy institucioneve, në lidhje me ushtrimin e kompetencave të tyre. Në këtë kontekst Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë kanë rënë dakord që bashkëpunimi midis dy institucioneve të materializohet përmes nënshkrimit të një memorandumit që të reflektojë këto parime pune. Për më shumë shih: <http://klgj.al/aktivitet-date-29-shtator-2020-keshilli-i-larte-gjyqesor-zhvilloi-nje-takim-pune-me-inspektorin-e-larte-te-drejtësisë-z-artur-metani/>

Deri në këto momente, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka përfunduar shqyrtimin në seancë dëgjimore publike, të dy kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të dy magjistratëve, për të cilët ka vendosur masën disiplinore shkarkim nga detyra. Saktësojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk bën kërkesë për të nisur procedim disiplinor ndaj magjistratëve, por shqyrton në çdo rast kërkesat e ardhura nga ILD.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!